

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Ren dor (1)	Data e rregjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
1	10.3.2015	-Një fotokopje të vendimarrjes së institucionit të datës 05.03.2015, në lidhje me Manastirin e “Shën Kollit”, në Mesopotam, Sarandë	18.03.2015 Vihet në dispozicion një kopje të vendimarrjes së KKR - së në lidhje me objektin “Kisha e Shën Kollit“, në Manastirin e Mesopotamit, Sarandë, vendimi nr. 32, datë 05.03.2015.	Përfunduar	Nuk ka
2	13.03.2015	-Në fotokopje të proces-verbalit të mbledhjes së institucionit më datë 05.03.2015, sa i përket diskutimeve në lidhje me Manastirin e “Shën Kollit“, në Mesopotam, Sarandë -Një kopje të projektit të miratuar nga ana e institucionit më datë 05.03.2015, në lidhje me Manastirin e “Shën Kollit“, në Mesopotam, Sarandë	23.03.2015 -Bazuar në pikën 4 të nenit 3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ku citohet:”Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji. -Për vënien në dispozicion të një kopje të projektit të miratuar nuk mund të merret në konsideratë, pasi platformat e paraqitura nga kandidatët nuk janë dokumente zyrtare.	Përfunduar	Nuk ka
3	25.03.2015	-Një kopje të shkresës nr. 39 prot, vendimi nr.	01.04.2015 (Bashkëlidhur dërgohet: -Një kopje të shkresës nr. 39	Përfunduar	Nuk ka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURES
“GANI STRAZIMIRI”

		8, datë 08.04.2008 i KKR - së -Një kopje të shkresës nr. 95 prot, vendimi nr. 5, datë 04.06.2009 i KKR - së -Një kopje të shkresës nr. 56 prot, vendimi nr. 2, datë 04.05.2010 i KKR - së -Një kopje të shkresës nr. 6 prot, vendimi nr. 1, datë 30.03.2012 i KKR - së)	prot, vendimi nr. 8, datë 08.04.2008 i KKR - së -Një kopje të shkresës nr. 95 prot, vendimi nr. 5, datë 04.06.2009 i KKR - së -Një kopje të shkresës nr. 56 prot, vendimi nr. 2, datë 04.05.2010 i KKR - së -Një kopje të shkresës nr. 6 prot, vendimi nr. 1, datë 30.03.2012 i KKR - së)		
4	08.04.2015	Shpjegime mbi refuzimin e dhënies së informacionit dhe dokumenteve zyrtare në lidhje me kërkesën e datës 13.03.2015	14.04.2015 Përsa i përket vënies në dispozicion të një kopje të proces- verbalit të datës 05.03.2015, për shqyrtimin e projektit të Manastirit të “Shën Kollit”, në Mesopotam, Sarandë; bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 17 Kufizime, në pikën 2, specifikohet se:“ E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj pikës e) këshillimi dhe diskutimi paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike. Proces - verbali përmban diskutime mbi projektin ndërmjet autoriteteve publike dhe diskutime për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, pjesë e së cilës është dhe manastiri i “Shën	Përfunduar	





MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURES
“GANI STRAZIMIRI”

			Kollit”. Ndërsa, përsa i përket projektit të miratuar nga ana e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve më datë 05.03.2015, në lidhje me Manastirin e “Shën Kollit”, në Mesopotam, Sarandë, ju bëjmë me dije se: “Në bazë të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve nuk është i autorizuar nga autori për të vënë në dispozicion projektin ndaj personave të interesuar”. Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, vetëm pasi ju të merrni autorizimin nga autori i projektit dhe në bazë të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005, do t’ju vërë në dispozicion një kopje të tij.		
5	20.04.2015	Dergim vendimi Për urdhërimin e Autoritetit Publik për të dhënë informacionin e kërkuar ankuesit brenda datës 24.04.2015	22.04.2015 Vendim për dhënien e informacionit/dokumentacionin e kërkuar në lidhje me kërkesën e datës 13.03.2015 Bazuar në gërmën “gj”, të pikës 1, të nenit 7, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, është vënë në dispozicion sa më poshtë: -Një kopje të proces verbalit të mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Restaurimeve mbajtur më datë 05. 03. 2015, që i përket diskutimeve në lidhje me Manastirin e “Shën Kollit”,	Përfunduar	5000





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURES
“GANI STRAZIMIRI”

			në Mesopotam, Sarandë. -Një kopje të projektit të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, më datë 05. 03. 2015, në lidhje me Manastirin e “Shën Kollit”, në Mesopotam, Sarandë. Bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenin 13, kostoja e shërbimit, në pikën 1 përcaktohet se: “Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas”. Përsa më sipër, jeni të lutur të paraqiteni pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës për të tërhequr një kopje të projektit kundrejt pagesës.		
--	--	--	---	--	--

